



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 18132 prot.

Vlorë, më 08.09.2026

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR

DATE 27.08.2026 ORA 10:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2027 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.16533 prot, datë 13.08.2026.

Marrin pjesë:

Kryetar e Bashkisë Vlorë znj.Brunilda Merini, Kryetari i N.J.A.Qendër- z.Genard Fegaj, Drejtor i Financës – z. Hiqmet Haxhaj, drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.

(Në takim morrën pjesë më shumë se 22 persona.)

Takimin e hap Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersini: Ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe për problematikat e ngritura. Kemi lënë disi pas vëmendjen ndaj fshatrave dhe duhet të bëjmë një ndarje të tillë që shpërndarja e buxhetit të jetë sa më e barabartë ndërmjet qytetit dhe njësive administrative. Kanina ka qenë një zonë që është parë me më shumë vëmendje. Aktualisht kemi një investim për rrugën që të çon drejt varrezave. Një problem i rëndësishëm mbetet ndriçimi. Ndriçimi do të jetë një zgjidhje që do të adresojmë dhe shpresojmë që deri më 15 tetor të pajisemi me ndriçim.

Nuk do ta ndajmë Vlorën nga komunat dhe njësitë administrative. Kemi qenë të fokusuar në qytetin e Vlorës, veçanërisht në pastrimin dhe infrastrukturën, por vëmendja duhet të shtrihet në të gjithë territorin. Për Panajan, është e nevojshme pajisja me kontrata uji, në mënyrë që banorët të kenë furnizim të rregullt me ujë. Në Zvërnec ka nisur ndërhyrja për problemin e furnizimit me ujë. Në Nartë, projekti për furnizimin me ujë pritet të përfundojë së shpejti, ndërsa në vitin 2027 do të bëhet implementimi i projektit për furnizimin me ujë të Zvërnecit.

Sa i përket rrugës së Kuzum Babasë, problem mbetet përsëri plasja e tubacioneve të ujit, pasi rrjeti është i amortizuar. Në muajin tetor do të fillojë zëvendësimi i rrjetit të ri, pjesë-pjesë. Do të merremi gjithashtu me menaxhimin e tokave në të gjithë zonën. Kush disponon AMTP-në, duhet të dorëzojë një kopje pranë strukturave përkatëse, në mënyrë që të mund të trajtojmë problematikat e pronësisë dhe administrimit të tokave. Jemi të hapur për t'ju dëgjuar

Banor: Kërkohet heqja e gardheve dhe lirimi i hapësirave publike, me qëllim rikthimin e tyre në funksion të komunitetit. Në lagjen “24 Maji” kemi hasur pengesa për vijimin e procesit të zgjerimit të rrugës, pasi në disa prej banesave nuk ka persona të pranishëm për të mundësuar vijimin e procedurave.

Banor: Në Kaninë, problematikat kryesore lidhen me rrugën e varrezave si dhe gjendja e sheshit. Gjithashtu, kërkohet ndërhyrje në rrugën lidhëse ndërmjet Kaninës dhe Shërishtes, ku nevojiten rreth 600 metra rrugë për ta vënë në funksion. Një problem tjetër është mungesa e hapësirave në varreza, për shkak të kufizimit të sipërfaqes së tokës. Gjithashtu, kërkohet ndërhyrje dhe për përmirësimin e rrugës Kaninë–Ujë i Ftohtë.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersini: Rruga Kaninë–Sherishtë është përfshirë në projekt dhe do të trajtohet në kuadër të ndërhyrjeve të planifikuara.



Banor: Janë dëmtuar dhe kanë plasur tubacionet e ujësjellësit, duke shkaktuar ndërprerje të furnizimit me ujë të pijshëm në Kaninë.

Banor: Problematika kryesore lidhet me ndriçimin në tre rrugë të Zvernecit. Gjithashtu, kërkohet ndërhyrje për rregullimin e sheshit të fshatit dhe rehabilitimin e çezmës së vjetër.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersini: Në muajin nëntor pritet të përfundojë ndërhyrja për zgjidhjen e problemit të ndriçimit.

Banor: Kërkohet ndërhyrje për sistemimin e rrugëve të brendshme të fshatit, si dhe ndërtimi i një muri mbrojtës për të evituar rrëshqitjet e dherave. Gjithashtu, kërkohet ndërhyrje në sheshin para shkollës, me qëllim krijimin e një hapësire të përshtatshme për argëtimin dhe komunitetin. Nevojitet gjithashtu një skrep për pastrimin dhe largimin e mbetjeve.

Banor i fshatit Panaja: Problematikë paraqet gjendja e varrezave, pasi hapësira aktuale nuk është e mjaftueshme. Kërkohet ndërhyrje për sistemimin dhe përmirësimin e rrugëve të fshatit. Gjithashtu, problem mbetet furnizimi me ujë. Kërkohet pastrimi i kanalit të ujërave të larta, pasi në rast reshjesh të dendura ekziston rreziku i përmbytjeve.

Banor i fshatit Xhuherinë: Fshati ka nevojë për një skrep për kryerjen e punimeve dhe pastrimeve të nevojshme, për ndërhyrje në kolektor, si dhe për ndriçim publik.

Banor i fshatit Bestrovë: Kërkohet ndërhyrje për sistemimin e rrugëve të brendshme të fshatit, përfshirë edhe rrugën e varrezave, si dhe rehabilitimin e rrugës që lidh fshatin me rrugën nacionale. Problem mbetet gjithashtu ndriçimi i fshatit. Në zonën e liqenit të Bestrovës, qarkullimi me mjete është i pamundur për shkak të rrugëve të bllokuara, ndaj kërkohet ndërhyrje për hapjen dhe sistemimin e tyre.

Banor i fshatit Hoshtimë: Problem mbetet ndriçimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve, si dhe gjendja e rrugëve të fshatit. Gjithashtu, kërkohet ndërhyrje në kanalën furnizues, i cili mbledh ujërat që vijnë nga kodra dhe i përcjell drejt liqenit.

Banor i fshatit Babicë: Problematikë kryesore mbetet mungesa e furnizimit me ujë, si dhe problematika e ujërave të zeza. Kërkohet ndërhyrje për sistemimin e rrugëve kryesore dhe të brendshme të fshatit, përfshirë edhe rrugën "Ali Koka". Gjithashtu, kërkohet krijimi i një hapësire të përshtatshme për argëtimin e fëmijëve.

Banor i fshatit Nartë: Problem mbetet furnizimi me ujë, ndriçimi, si dhe gjendja e rrugëve të brendshme të fshatit, veçanërisht segmenti rrugor nga kisha deri te shkolla.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersini: Narta është përfshirë në projekt.

Banor i fshatit Babicë: Problem mbetet furnizimi me ujë, gjendja e rrugëve për lëvizjen e mjeteve bujqësore, veçanërisht traktorëve, si dhe kanalizimet.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersini: Shërbimet në sistemin e-Albania do të merren në njësitë administrative.

Faleminderit!

Konceptoi:
Aurora Kamberaj
Koordinatore për Njoftim dhe Konsultim Publik

